



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2019:125910
Datë: 24.04.2024
Numri i dokumentit: 05613862
C.nr.246/18

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-Dega në Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me sekretaren juridike Azemine Berisha, duke vendosur në çështjen kontestimore juridiko-civile të paditësit, L. B. nga Hani Elezit, të cilin me autorizim e përfaqëson M. K.-B., avokate nga Kaçaniku, kundër të paditurës Kompania “ ...”, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson, G. N., avokat nga Prishtina, për çështjen kontestuese kompensimi i dëmit, në seancën kryesore, të mbajtur me date 22.03.2024, në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjygjëse, ndërsa më date 24.04.2024, bëri përpilimin me shkrim të këtij:

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit, L. B. nga Hani Elezit dhe DETYROHET, e paditura “ ...”, me seli në Prishtinë, që paditësit të i’u paguaj shumë prej 7.162.91€, në emër të kompensimit të dëmit, të shkaktuar në shtëpinë e banimit P+1, e ndërtuar në parcelën kadastrale ..., e cila gjendet në zonën kadastrale Hani i Elezit.

Këtë shumë me kamatë prej 8%, duke filluar prej datës 22.03.2024,(data e seancës kryesore), e deri në pagesën definitive.

II. DETYROHET, e paditura që paditësit t’ia paguaj shumën në pikën I të këtij aktgjykimi si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë prej 1,828.00€, të cilat pagesa do të bëhen, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit në dorëzim të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarës, si në padi ashtu në seancat e mbajtura, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta miratoj në tersi si të bazuar dhe ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia paguajnë shumën prej 7.162.91€, në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në shtëpinë e banimit P+1, e ndërtuar në parcelën kadastrale ..., e cila gjendet në zonën kadastrale Hani i Elezit.

Po ashtu ka theksuar se paditësi, është posedues i parcelës kadastrale ..., në vendin e quajtur "...", me kulture tokë ndërtimore, në sipërfaqe prej 678m², e cila gjendet në ZK Hani i Elezit, e cila evidentohet në emër të babait të paditësit, e në të cilën ngastër pala paditëse e ka të ndërtuar shtëpinë e banimit, e ky fakt vërtetohet nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Ka theksuar se e paditura, me veprimet dhe punimet, të cilat i ka bërë me makineri të rëndë, në afërsi të shtëpisë së paditësit, ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material në shtëpinë e tij, për shkak të presionit dhe dridhjeve të shkaktuara nga këto makineri, të cilat kanë punuar në ndërtimin e autostradës Prishtinë - Hani Elezit.

Paditësi, menjëherë e ka njoftuar të paditurën, për dëmin e shkaktuar në shtëpinë e tij dhe ia ka paraqitur të paditurës kërkesën për kompensimin e dëmit, por e paditura nuk ka ndërmarrë asgjë për evitimin e këtij dëmi në procedure jashtë gjyqësore.

Paditësi përmes fotove të bëra, në shtëpinë e tij e ka dëshmuar se i është bërë dëm i konsiderueshëm material dhe kostoja për sanimin e këtij dëmi dhe kthimin në gjendje të mëparshme është e lartë. Po ashtu se dëmi është shkaktuar në shtëpinë e tij, nga punimet e të paditurës, është vërtetuar edhe nga dalja në vend shikim i komisionit për vlerësimin e dëmeve të Komunës së Hanit të Elezi, atë sipas procesverbalit të datës 04.10.2018, i lëshuar nga Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në komunën e Hanit të Elezit.

Ky komision ka konstatuar se nga veprimet e të paditurës, janë shkaktuar dëme në shtëpinë e paditësit dhe në procesverbal, janë të shënuar dëmet të cilat i janë shkaktuar palës paditëse.

Po ashtu nga raporti i vlerësimit, i punuar nga Eksperti Vlerësues i Ndërtimtarisë S. B., dhe sqarimeve të dhëna në seancën e datës 22.11.2023, është konstatuar se në shtëpinë e paditësit,

është shkaktuar dëm gjatë ndërtimit të trupit të autostradës Prishtinë –Hani i Elezit, ku dëmi është shkaktuar nga e paditura “...” , për shkak të punimeve me makineri të rënda, ku kostoja për kompensimin e dëmit material është në vlerë prej 7.162.91€.

Gjithë ashtu nga ekspertiza e muajit Janar të vitit 2024, e punuar nga eksperti i gjeologjisë S. H. dhe sqarimeve të bëra në seancë të datës 22.03.2024, është vërtetuar se deri tek dëmi në shtëpinë e paditësit dhe murin mbrojtës ka ardhur nga veprimet e të paditurës, gjatë punimeve në periudhën kohore 2017-2018, në ngjeshjen e rrugës me makineri të rënda për gjatë autostradës Prishtinë Hani i Elezit.

Ka theksuar se nga provat e administruara, si procesverbalet e DBPZHR-së, fotot e shtëpisë së dëmtuar, raportit të vlerësimit të ekspertit vlerësues, plotësimin e bërë në seancë, ekspertiza e ekspertit të gjeologjisë, është vërtetuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar konform nenit 136 të LMD- së .

Me qenë se dëmi është shkaktuar nga veprimet e të paditurës, respektivisht qarja e mureve në shtëpi , ka ardhur nga dridhjet e shkaktuara nga makineritë e të paditurës, gjatë hapjes së rrugës , lëvizjeve dhe ngjeshjes së tokës në afërsi të shtëpisë së paditësit, e të cilat makineri kanë punuar në ndërtimin e autostradës Prishtinë-Hani Elezit, prandaj përgjegjëse për kompensimin e dëmit është e paditura. Prandaj, nga këto baza i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta miratoj në tersi si të bazuar.

Shpenzimet i ka kërkuar.

I autorizuari i të paditurës, si në përgjigje në padi, ashtu edhe në seancat e mbajtura gjyqësore i ka propozuar gjykatës, që kërkesëpadinë e paditësit, ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar sepse nuk është vërtetuar baza Juridike e kërkesëpadisë.

Pala e paditëse, ka dështuar në tersi, që ta vërteton lidhen kauzale, mes dëmeve të pretenduara dhe veprimeve/mosveprimeve të paditurës. Në këtë drejtim, asnjëra nga ekspertizat e nxjerrura, nuk ka arritur ta dëshmon këtë fakt kurcial në këtë kontest.

Dështimi i palës paditëse, për ta vërtetuar lidhjen kauzale, u tentua të vërtetohet me dy ekspertiza edhe atë të ndërtimitarisë dhe gjeologjisë. Konstatimet e bëra në këto ekspertiza, janë

tersishte kundërthënës njëra me tjetrën. Në ekspertizën e ekspertit L. D., është konstatuar se në pronën e paditësit, qenkan vetëm disa “dëme anësore”, për të cilat nuk mundë të konstatohet, se janë bërë nga punimet e të paditurës, ndërsa eksperti tjetër i ndërtimtarisë S. B., “çpik”, dëmin në shumë prej mbi 7 mijë euro.

I autorizuari ka theksuar se ekspertiza e ekspertit S. B., është tërësisht e pa mbështetur në prova, nuk e din se kur saktësisht ka ndodhur dëmi, çfarë makinerie ka përdorur e paditura me rastin e ndërtimit të rrugës dhe cili ka qen ndikimi i makinerive të pretenduara.

Po ashtu edhe Ekspertiza e ekspertit të gjeologjisë, nuk ofron përgjigje në asnjë përgjigje, se kurë është shkaktuar dëmi, cilat makineri janë përdorur, sa ka qen ndikimi i tyre në dëmin e shkaktuar, nuk tregon se sa ka qen amplituda e dridhjeve, të cilat e paskan shkaktuar dëmin e pretenduar.

I autorizuari e ka kontestuar edhe ekspertizën e ekspertit të gjeologjisë, sepse eksperti në seancën e datës 22.03.2024, ka konfirmuar, se ai nuk mundi ti din makinat të cilat i ka përdorur e paditura, amplitudën e dridhjeve të shkaktuara nga ato makineri dhe nuk ofroi asnjë fakt me të cilën do ta krijonte lidhjen kauzale në rastin konkret.

Eksperti i gjeologjisë, nuk ishte në gjendje të tregoj, se kurë është ndërtuar shtëpia, cilat dëme janë shkaktuar dhe kohën e shkaktimit të dëmeve. Deklarimi i tij se dëmi është shkaktuar “diku në vitet 2017 dhe 2018”, paraqesin absurd, bëhet fjalë për 2 vite të plota, pra nuk e din kohën e saktë, kur është shkaktuar dëmi. Meqenëse pala paditëse, ka dështuar në tërësi që ta vërteton lidhjen kauzale dhe ta vërteton bazën e kërkesëpadisë, prandaj nga këto baza, kërkesëpadia është e pa bazuar.

Shpenzimet i ka kërkuar

Për të vërtetuar gjendjen e plotë faktike dhe gjykuar në mënyra të drejtë ne këtë çështje kontestimor, të kompensimit të dëmit, gjykata bëri administrimin e këtyre provave të shkruara duke bërë leximin e këtyre provave të shkruara : kërkesa 06.11.2018, procesverbali i datës 04.10.2018, certifikata e pronës, fotot e shtëpisë së dëmtuar, përgjigja në padi, ekspertiza e ekspertit L. D., ekspertiza e ekspertit S. B., sqarimet e bëra në seancë, ekspertiza e ekspertit të gjeologjisë, dhe sqarimet e bëra në seancë, pa vërejtje.

Pas vlerësimit me kujdes dhe profesionalizëm të secilës prove veç e veç dhe të gjithave bashkërisht, e në bazë të dispozitave të nenit 8 të LPK-së, si dhe bindjes së lirë të gjykatë, kjo gjykatë për këtë çështja kontestimore vërtetohet këtë gjendje këtë gjendje faktike:

Paditësi, është posedua i pronës, ku është e ndërtuar shtëpia, shtëpia është e ndërtuar në ngastrën kadastrale ... Z.K Hani i Elezit, kjo shtëpi është dëmtuar nga dridhjet, të cilat janë shkaktuar nga punimet me makineri të rënda, dëmi i shkaktuar arrin shumën prej 7.162.91 €, ky dëm është shkaktuar me veprimin e të paditurës dhe e paditura është përgjegjëse për kompensimin e dëmit.

a) Se paditësi është posedues, i pronës ku është ndërtuar shtëpia e banimit, këtë fakt Gjykata e ka vërtetuar, nga thëniet në padi, theksimet e bëra nga pala paditëse, e cila ka theksuar ,se prona në shërbimin e gjeodezisë, evidentohet në emër të M. B., babait të paditësit.

b) Se në ngastrën kadastrale ..., është ndërtuar shtëpia e banimit, këtë fakt Gjykata e ka vërtetuar nga raporti i vlerësimit të ekspertit vlerësues, i cili ka konstatuar, se në këtë ngastër është e ndërtuar shtëpia e banimit e tipit P+1, e cila është me dimensione 8.30 x 11.10 m, e cila në mënyrë detale është përshkruar në faqen e 3 të raportit të vlerësimit.

c)se muret e shtëpisë së paditësit janë dëmtuar, këtë fakt Gjykata, e ka vërtetuar nga raporti i vlerësimit, të ekspertit vlerësues S. B., i cili në raportin e vlerësimit, ka konstatuar, se shtëpia gjendet në ngastrën kadastrale ..., është dëmtuar edhe atë: Janë shkaktuar plasaritje e korridorit, sallonit, dhomave të fjetjes, banjë, fasada, etj, të cilat janë konstatuar në faqen 3, të raportit të vlerësimit, të gjitha këto janë bërë nga dridhjet të cilat janë shkaktuar nga makineritë të cilat kanë punuar në auto-udhë.

Po ashtu ky fakte është vërtetuar edhe nga ekspertiza e ekspertit të gjeologjisë, e punuar nga eksperti S. H. dhe sqarimet e bëra në seancë, është vërtetuar se deri tek dëmi në shtëpinë e paditësit, ka ardhur nga veprimet e të paditurës , gjatë punimeve në periudhën kohore 2017-2018, në rregullimin dhe ngjeshjen e rrugës me makineritë e rënda, përgjatë autostradës “Arbër Xhaferri”, Prishtinë Hani i Elezit.

c) Dëmi i cili i është shkaktuar paditësit, arrin shumën prej 7.162.91 €, e këtë fakt Gjykata e ka konstatuar nga Raporti i Vlerësimit, të ekspertit vlerësues S. B., si dhe sqarimeve të bëra në seancë. Nga ky raport i vlerësimit, është vërtetuar se paditësit i është shkaktuar dëm, sepse është bërë qarja e mureve të shtëpisë. Eksperti lartësinë e dëmit e ka konstatuar në mënyrë detale në faqen 6 dhe 7, ku është përshkruar, se sa do të kushtojë sanimi i këtij dëmi në shtëpinë e banimit. Këtij raporti të vlerësimi Gjykata i'a dha besimin sepse i njëjti është punuar në mënyrë profesionale dhe ka pasqyruar gjendjen reale të dëmit të shkaktuar, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

d) Ky dëm është shkaktuar me veprimet e të paditurës, sepse e njëjta i ka kryere punët në ndërtimit të auto-rrugës Prishtinë-Hani Elezit, pra është fakt i ditur se e njëjta i ka kryer punët në atë rrugë dhe me veprimet e sajë e ka bërë edhe dëmtimin e pronës së paditësit. Dëmi është shkaktuar nga makineritë e sajë, të cilat kanë shkaktuar dridhje të mëdha, nga të cilat dridhje ka ardhur deri te dëmtimi (qarja e mureve të shtëpisë dhe murit mbrojtës). Po ashtu ky fakt është vërtetuar nga fotot, të cilat gjinden në shkresat e lëndës, procesverbalet e komisionit të komunës së Hanit të Elezit, Raportit të Vlerësimit të ekspertit vlerësues dhe plotësimi i raportit i bërë në seancë.

Po ashtu ky fakte vërtetohet edhe nga ekspertiza e ekspertit të gjeologjisë, ku është konstatuar se deri tek dëmi në shtëpinë e paditësit, ka ardhur nga veprimet e të paditurës, gjatë punimeve në periudhën kohore 2017-2018, në rregullimin dhe ngjeshjen e rrugës me makineritë e rënda përgjatë autostradës “Arbër Xhaferri”, Prishtinë Hani i Elezit.

Gjykata e ka miratuar kërkesëpadinë e paditësit, duke u bazuar në nenit 136 par 1 të LMD-së, me të cilën dispozitë është paraparë se për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit, është e nevojshme të jetë shkaktuar dëmi, të dihet shkaktuesi i dëmit dhe të ekzistojnë parakushtet e përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit mbi bazën e fajësisë.

Gjykata, pas analizimit të provave, kërkesëpadinë e paditësit, e ka miratuar në tërësi si të bazuar dhe e ka detyruar të paditurën që paditësit të i'a paguaj shumën e dëmit në vlerë prej 7.162,91€, sepse ky dëm është shkaktuar me fajin e të paditurës, gjegjësisht nga lëvizja e makinave të rënda të paditurës. Ky dëm dihet se është shkaktuar nga e paditura, pasi që e paditura e ka fituar tenderin dhe i ka kryer punimet në rregullimin e autostradës “ Arbër Xhaferi” Prishtinë-Hani Elezit.

I dëmtuari-tani paditësi, e ka identifikuar shkaktarin e dëmit, me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa barra e përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit i përket shkaktuesit të dëmit të paraqitur nga i dëmtuari, sepse sipas ligjit ai e ka përgjegjësinë e prezumuar.

Mbi bazën e kësaj gjendje të vërtetuar faktike, e cila u vërtetua në mënyrë të plot dhe të drejt që rezultoi nga të gjitha provat e nxjerrura dhe të vlerësuara, gjykata vlerëson se janë eliminuar të gjitha faktet kontestuese për vendim marrje dhe kërkesëpadinë e paditësit e miratoi në tërësi si të bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit, duke zbatuar dispozitën e nenit 323 të LPK-së.

Meqenëse e paditura, ka rënë në vonesë me kompensimin e dëmit, Gjykata me kërkesën e paditësit dhe në bazë të nen.382 të LMD-së, e detyroi të paditurën që paditësit në shumat e gjykuara t'ia paguaj edhe kamatën prej 8% duke filluar nga data 22.03.2024(data nxjerrjes së aktgjykimi , e deri në pagesën definitive.

Gjykata i analizoi theksimet e palës paditëse, e cila kërkoi nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta miratoj në tërësi si të bazuar, këtyre theksimeve gjykata u'a dha besimin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Sepse, është fakt i ditur, se me veprimet e të paditurës, për shkak të kryerjes së punimeve në autostradën Prishtinë-Hani Elezit, nga dridhjeve të cilat janë shkaktuar nga makinat e të paditurës ka ardhur deri tek qarjet-dëmtimi i pronës së paditësit shtëpisë dhe murit mbrojtës.

Këto pretendime janë vërtetuar nga procesverbali i datës 04.10.2018, i lëshuar nga Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Hanit të Elezit , fotot e pronës së dëmtuar, ekspertiza e ekspertit vlerësues S. B. dhe plotësimi i bër në seancë, pastaj Ekspertiza e ekspertit të gjeologjisë.

Gjykata i analizoi edhe theksimet e të paditurës, e cila përmes të autorizuarit i propozoj gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar, për arsye se paditësit i mungon legjitimiteti aktiv procedural dhe material për të qenë e palë paditëse. Bazuar në certifikatën e pronës e cila u administrua si provë në këtë procedurë , konstatohet se pronar i palujtëshmërisë është personi tjetër (M. B.), e jo paditësit L. B.. Me asnjë provë nuk është vërtetuar çfarëdo lidhëshmërie juridike apo faktike, të paditësit L. B. me palujtëshmërin

lëndore. Gjykata këto theksime, i analizoi, por nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes, sepse është fakt i ditur se punimet në auto rrugën Prishtinë – Hani Elezit, janë kryer nga e paditura dhe dëmi është shkaktuar me veprimet e të paditurës, e me nenin 136 të LMD-së, është paraparë se kush i shkakton dëm tjetrit duhet të i'a kompensoj.

Gjykata e detyroi të paditurin që paditësit të ja paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1.828,00€ €, edhe ate shumën prej 104 € për përpilimin e padisë, shumën prej 810,00 € për 6 seanca gjyqësore, shumën prej 104.00€, për precizimin e kërkesëpadisë, shumën prej 100.00€ për ekspertizën e ekspertit të ndërtimtarisë, shumën prej 350,00€, ekspertizën e ekspertit të gjeologjie, shumën prej 300€, për ekspertizën e ekspertit të ndërtimtarisë dhe shumën prej 60 € në emër të taksës për padi (të parapara sipas udhëzimit administrativ nr.1/2017 të Këshillit Gjyqësorë), gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452.1 të LPK-së

Nga të gjitha arsyet e paraqitura dhe rezultatet e përgjithshme të procedurës kontestimore, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

C.nr.246/2018 prej datës 22.03.2024

Gjyqtari

Riza LIVOREKA

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, pala e pa kënaqur, ka të drejtë të, paraqes ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Dërguar me datën 24.04.2024

Të autorizuarit të paditësit 1 x 1

Të autorizuarit të paditurës 1 x 1